# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-416482**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Greqia: Mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë/ Athina kërkon përparim të mëtejshëm për të drejtat e minoritetit grek |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/greqia-mbeshtesim-anetaresimin-e-shqiperise-athina-kerkon-perparim-te-met-i584386` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 19:55:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 20:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `29697405f898847ce670740a8a9a1d5579f99cac465b58d3da7eb7f61802f3f4` |
| TEKSTI | `cd0e15d58b7211afbc7e8acaae67ceb29d0e7f75df63ecf80b90a51807eb4eaa` |
| PAMJA | `764af545c9f04ddc85451bed3901c69d5906cf0eaa0786a5bb25d72e44011523` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `366f3dfe5856e477c0cc48f270ca1fe39a96c3f7fa3b1b2717fffe06d637fbf9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/366f3dfe5856e477c0cc48f270ca1fe39a96c3f7fa3b1b2717fffe06d637fbf9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Greqia: Mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë/ Athina kërkon përparim të mëtejshëm për të drejtat e minoritetit grek

6 Shtator 2026, 22:35Rajoni TEMA

Greqia: Mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë/ Athina

Greqia mbështet me rezerva anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Në konferencën ndërkombëtare të Selanikut, kryeministri i Greqisë, Kiriakos Mitsotakis, rikonfirmoi mbështetjen e Greqisë për integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor.

*"Greqia mbetet në favor të perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, por progresi i secilit vend kandidat do të varet nga respektimi i sundimit të ligjit, detyrimeve ndërkombëtare dhe të drejtave të pakicave."*

Por Mitsotakis nuk e fshehu pakënaqësinë dhe njëherësh edhe kërkesën e fundit të Greqisë për Shqipërinë para anëtarësimit në BE, minoritetin grek.

*"Ne ende kemi probleme me pakicën kombëtare greke në Shqipëri, të cilat ia kemi sjellë në vëmendje palës shqiptare. Progresi që është bërë në regjistrimin e pronave dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave nuk është i mjaftueshëm"*

*Jini absolutisht të sigurt se në kohën e duhur do t'i ushtrojmë të drejtat tona, në mënyrë që të jemi absolutisht të sigurt se të drejtat e pakicës mbrohen. Çështja nuk është vetëm një çështje dypalëshe, por ka të bëjë me zbatimin e ligjit evropian dhe rregullave të respektimit të të drejtave të njeriut."*

Ndonëse kjo deklaratë e kryeministrit grek shihet si një paralajmërim për Shqipërinë, Mitsotakis nuk përmendi në asnjë rast fjalën veto. Madje ai vlerësoi se në krahasim me Maqedoninë e Veriut, Shqipëria është shumë hapa para në procesin e anëtarësimit në BE.

*"Maqedonia e Veriut nuk ka përparim të konsiderueshëm në negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian.*
*Ky vend është në një fazë shumë më të hershme krahasuar me Shqipërinë, një fakt që aktualisht nuk lejon që çështje të ngjashme të ngrihen gjatë zhvillimit të procesit të saj të pranimit."*

Greqia e ka përdorur më herët mekanizëm për të ngrirë negociatat e Shqipërisë me BE, kur në vitin 2023 në Himarë u arrestua ish-kandidati për kryebashkiak Fredi Beleri për shitblerje votash. Tashmë ujërat mes Athinës dhe Tiranës janë zbutur. Por testi i fundit i marrëdhënieve mes Greqisë dhe Shqipërisë do të jetë gjysma e dytë e vitit 2027, kur Athina të udhëheqë Presidencën e BE, në të njëjtën kohë kur Shqipëria synon të përmbyllë gjithë fazën e negociatave.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Serbia abstenoi për hartën e re në OKB, me arsyetimin se Kosova u shfaq si shtet i pavarur

19:25 Rajoni

"Nuk kërkojmë lejen e askujt," Mitsotakis: Greqia ka të drejtë të zgjerojë ujërat territoriale në 12 milje kur ta konsiderojë të përshtatshme

16:05 Rajoni / 18 komente

Ngërçi institucional, Kosova rrezikon të humbë 166 milionë euro nga Plani i Rritjes i BE-së

13:55 Rajoni / 5 komente

Protesta masive në Kroaci, qytetarët kërkojnë pastrimin e një landfilli me mbetje të rrezikshme

12:05 Rajoni / 3 komente

Greqia ul taksat dhe rrit pagat, Mitsotakis prezanton paketën me masa për familjet, bizneset dhe fermerët

10:25 Rajoni / 3 komente

Pandeli Majko: Zgjedhja e presidentit të republikës, në Prishtinë, po kthehet në një 'lodër' vetvrasëse!

10:15 Rajoni / 37 komente

"Liri për çlirimtarët!" - pas Prishtinës e Dyseldorfit, mesazhi për ish-krerët e UÇK-së të hënën në Times Square

09:55 Rajoni / 6 komente

Aksidenti tragjik në Greqi i merr jetën regjisores 29-vjeçare, familjarët gati t'i realizojnë filmin e fundit

22:15 Rajoni / 2 komente

Në pritje të vendimit për ish-krerët e UÇK: Tubime në mbështetje të tyre me 12 dhe 16 shtator

21:30 Rajoni / 2 komente

Kroacia miraton blerjen e 18 sistemeve raketore Chunmoo nga Koreja e Jugut

19:45 Rajoni

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikë...**

12:25 Politika / 98 komente

**[Shkon për vetulla, por gjen protesta - Meçe: Sali Berishë...]()**

20:55 Politika / 18 komente

**[Rama përballë 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasard...]()**

08:45 Politika / 50 komente

**[Pronat para viteve ’91/ Kadastra hap aplikimin online, pë...]()**

14:25 Sociale / 5 komente

**[“Pushteti është një kafshë e përbindshme” - Rama për Ilir...]()**

15:25 Politika / 45 komente

## Blog Tema

**[Pritja e qytetarëve nga titullarët, formalitet apo detyrim?]()**

19:35 Blog

**[Vetëm 8% probabiliteti në Polymarket për rënien e qeverisë Rama këtë vit…]()**

11:03 Blog

**[GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës!]()**

10:05 Blog / 12 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.